



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË, VLORË

URDHËR

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT PËR HEQJEN E PJESËSHME TË
MASËS SË SEKUESTROS PREVENTIVE

Në Vlorë, viti 2014, muaji Korrik, datë 25.

Unë Klodjan Braho, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, pasi u njoha me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr.378 rregj datë 24.07.2014;

KONSTATOVA:

Se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.378 rregj datë 24.07.2014, mbi bazën e kërkesës së shoqërisë "Hauxhari" sh.p.k me objekt heqjen e masës së sekuestros preventive, ka vendosur;

1. Pranimin e pjesëshëm të kërkesës.
2. Heqjen e masës së sigurimit "sekuestro preventive", e vendosur me vendimin me nr.247, datë 12.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për objektin në ndërtim 10-12 kate, ndodhur në lagjen "Skelë", Vlorë, duke urdhëruar heqjen e cdo efekti të kësaj mase sigurimi ndaj të interesuarit shoqëria "Hauxhari" sh.p.k, me administrator Fatmir Hauxhari.
3. Lënien e masës së sigurimit pasurore "sekuestro preventive", mbi pjesët në ndërtim, në tërësinë e objektit të përfunduar, të ndodhur në lagjen "Skelë", Vlorë, për të cilin me vendimin me nr.2/283 dt.28.09.2011 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë është miratuar destinacioni i sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij dhe me vendimin me nr.2/284, dt.28.09.2011 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë është miratuar leja e ndërtimit, mbi sipërfaqen e ndërtimit (30 % të sipërfaqe së ndërtuar) dhe mbi të gjithë titujt që përfitojnë të pandehurit Amat Meta dhe Hasan Meta, të kontraktuar me kontratën nr.3451 Rep dhe nr.1083/2 Kol, datë 03.10.2011 të lidhur në Zyrën e Noterit Drita Aga midis të pandehurve Amat Meta dhe Hasan Meta dhe shoqërioe "Hauxhari" sh.p.k dhe "Breshani" sh.p.k.

Duke marrë parasysh sa me sipër, në bazë të nenit 274, 276/4 dhe 466 të K.Pr.Penale :

URDHËROJ:

1. Ekzekutimin e vendimit me nr.378 rregj datë 24.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është vendosur;
 - a. Pranimi i pjesëshëm të kërkesës.

- b. Heqja e masës së sigurimit "sekuestro preventive", e vendosur me vendimin me nr.247, datë 12.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për objektin në ndërtim 10-12 kate, ndodhur në lagjen "Skelë", Vlorë, duke urdhëruar heqjen e cdo efekti të kësaj mase sigurimi ndaj të interesuarit shoqëria "Hanxhari" sh.p.k, me administrator Fatmir Hanxhari.
- c. Lënia në fuqi e masës së sigurimit pasurore "sekuestro preventive", mbi pjesët në ndërtim, në tërësinë e objektit të përfunduar, të ndodhur në lagjen "Skelë", Vlorë, për të cilin me vendimin me nr.2/283 dt.28.09.2011 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë është miratuar destinacioni i sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij dhe me vendimin me nr.2/284, dt.28.09.2011 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë është miratuar leja e ndërtimit, mbi sipërfaqen e ndërtimit (30 % të sipërfaqe së ndërtuar) dhe mbi të gjithë titujt që përfitojnë të pandehurit Amat Meta dhe Hasan Meta, të kontraktuar me kontratën nr.3451 Rep dhe nr.1083/2 Kol, datë 03.10.2011 të lidhur në Zyrën e Noterit Drita Aga midis të pandehurve Amat Meta dhe Hasan Meta dhe shoqërive "Hanxhari" sh.p.k dhe "Breshani" sh.p.k.
2. Në zbatim të vendimit me nr.247, datë 12.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe në zbatim të vendimit nr.378 rregj datë 24.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ju bëhet me dije përfaqësuesve ligjor të shoqërive "Hanxhari" sh.p.k dhe "Breshani" sh.p.k, që pjesët takuese të të pandehurve Amat Meta dhe Hasan Meta të përcaktuara në kontratën për "ndarjen në natyrë të objektit të ardhshëm", me nr.2639 Rep dhe nr.890/1 Kol, datë 09.07.2012, të lidhur në zyrën e Noteres Drita Aga, nuk duhet që të tjetërsohen prej tyre te persona të tjerë, pasi në të kundërt do të mbajnë përgjegjësi sipas ligjit penal.
3. Per ekzekutimin e këtij urdhëri ngarkohet O.P.Gj Mirjan Fani, i cili të mbajë proces verbalin përkatës për zbatimin e këtij urdhëri, si dhe tju njoftojë subjekti të interesuar një kopje të urdhërit të ekzekutimit.

PROKURORI
Klodjan Braho
